

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Viti i ri shkollor, mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin! 25 mijë prej tyre ulen sot për herë të parë në banka
ADRESA	https://tpz.al/viti-i-ri-shkollor-mbi-340-mije-nxenes-ne-te-gjithe-vendin-25-mije-prej-t- yre-ulen-sot-per-here-te-pare-ne-banka-i332855
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:03:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:01:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	15fbfa8fd4d0029e0c61f7f57ef48f09c9b454b7e69d480dcbea0cd0b67a2bdc
TEKSTI	a654e66616d413696d19211eacc8302fcdcfcc02873d18aa94040256fa10b1af
PAMJA	ffc10cd4cee9ba4f33bead7bccda58d3fe97545d8ebc6f34ed945a90c3ca80ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6652334ddde3ab59129c9f3f548a20cd5914c35e80bf7ea23f80f5e217ab12c2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/6652334ddde3ab59129c9f3f548a20cd5914c35e80bf7ea23f80f5e217ab12c2

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

09:01 Viti i ri shkollor, mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin! 25 mijë prej tyre ulen sot për herë të parë në banka • 18:08 PDK e konsideron Kuvendin të pakonstituar dhe (

AKTUALITET, 14 SEPTEMBER 2026, 09:01

Viti i ri shkollor, mbi 340 mijë nxënës në të gjithë vendin! 25 mijë prej tyre ulen sot për herë të parë në banka

tpz.al TPZ



Në të gjitha shkollat e vendit sot ka nisur viti i ri mësimor. Mbi 340 mijë nxënës do të ulen në bankat e shkollës, me rreth 25 mijë nxënës që nisin për herë të parë shkollën.

Ky vit i ri shkollor 2026-2027 vjen me risi dhe investime të rëndësishme në institucionet arsimore. MAS në të gjitha shkollat e vendit ka shpërndarë tekstet shkollore për vitin e ri shkollor, ndërsa për herë të parë, i gjithë cikli i arsimit fillor, nga klasa e parë deri në klasën e pestë, është pajisur me tekste shkollore të reja dhe falas.

Ndërkohë 53 shkolla të reja ose të rehabilituara hapin dyert këtë vit shkollor, ndërsa më herët Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro ka bërë të ditur se janë miratuar edhe 39 projekte të tjera për rikonstruksionin e shkollave.

Me fokusin për sigurinë në shkolla, këtë vit do të jenë në shërbim të nxënësve mbi 400 oficerë sigurie, të cilët do të punojnë sipas protokolleve dhe standardeve të përditësuara. Paralelisht vëmendje i është dhënë edhe shërbimit psiko-social, me 900 psikologë dhe punonjës socialë që do të jenë të pranishëm në shkollat e vendit gjatë vitit shkollor 2026-2027, për t'iu përgjigjur nevojave sociale dhe emocionale të nxënësve. 20 shkolla të Tiranës janë pjesë e projektit pilot "Smart City", me kushte të shtuara sigurie përmes kamerave inteligjente.

Për herë të parë 408 shkolla në mbarë vendin janë pjesë e programit "Pas shkolle", duke u krijuar nxënësve mundësi për të mësuar, argëtuar dhe zhvilluar talentet e tyre në një mjedis socializimi dhe edukimi. Programi përfshin disa fusha, ndër të cilat "Bëjmë detyrat e shtëpisë", muzikë, teatër, kërcim, zeje dhe arte pamore. Përmes këtyre aktiviteteve synohet që nxënësit të kenë akses në orë cilësore pas mësimit, të zhvillojnë potencialin dhe aftësitë e tyre, si dhe të krijojnë më shumë mundësi për socializim.

Ndërkohë Ministria e Arsimit Mirela Kumbaro, me një videomesazh ka uruar të gjithë nxënësit në arsimin parauniversitar, një vit të mbarë shkollor.

ide!

Në Shqipërinë e sotme "revolucionin" ka emrin pjesëmarrje dhe alternative

Nga Preç Zogaj

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandit?

Nga Thoma Gëllçi

Tej e Këtej



Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori? Ola Xama tregon nga i duhet super

"Mirëmëngjes, këtë ditë të parë të shkollës të gjithë ju nxënës të dashur, mësues, prindër dhe gjyshër që sot shoqëroni nipër e mbesa në shkollë. Të dashur vogëlushë që sot nisni klasën e parë, që në fytyrë shfaqni buzëqeshje, por brenda jush keni shumë emocione dhe zemrat e vogla ju rrahin fort, kjo do të jetë një ditë që do ta mbani mend gjatë, ndoshta gjatë gjithë jetës suaj, prandaj ne të rriturit, mësuesit, drejtori i shkollës suaj, jemi kujdesur që kjo të jetë një ditë e bukur, e gëzueshme dhe ju të ruani kujtime të bukura prej saj.

Ju sot do të njihni shkollën tuaj, do të mësoni ku do të jetë klasa juaj, do të mësoni ku është palestra ku do të luani, oborri ku do të pushoni, laboratorit inteligjent i shkollës ku do të mësoni të bëni gjëra të bukura, do të mësoni emrat e shokëve dhe shoqeve tuaj. Ne sot jemi së bashku dhe do të jemi së bashku kështu e çdo ditë të vitit shkollor", shkruan Kumbaro.

Në mesazhin e saj ajo thotë se në këtë vit janë rreth 1200 nxënës që janë transferuar nga shkollat jo-publike në shkollat publike. Sipas Kumbaros kjo tregon besimin që ofron sistemi publik i arsimit.

Urime erdhën edhe nga kryeministri Edi Rama dhe presidenti Bajram Begaj.

[Regjion për Edukimin e Lartë dhe Shkencat](#)
imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 21:55

Dita e 45-së e protestës,
Divjaka kundër Territoriales:
Nuk pranojmë të bashkohemi
me Lushnjen

AKTUALITET / 13 September 2026, 21:01

Ilir Meta kërkon
zëvendësimin e masës "arrest
me burg", seanca nesër në
GJKKO

AKTUALITET / 13 September 2026, 20:32

Ndryshon vettingu për policët,
kërkohet që transferimi apo
ulja në detyrë të mos
ndërpresë procesin e
verifikimit

AKTUALITET / 13 September 2026, 19:37

"Nuk po na lejohet të marrim
nga qesja jonë", Rama
replikon me gjyqtarin: E
pabesueshme që e shikon
kështu buxhetin e shtetit
shqiptar

AKTUALITET / 13 September 2026, 18:56

Nafta në 229 lekë litri, Braçe:
Edhe Kosova furnizohet nga

AKTUALITET / 13 September 2026, 17:52

Reforma territoriale, Rama
nga Berati: Poliçani dhe

të njëjtët shitës që na shesin edhe ne, por nuk e ka rritur çmimin

Dimali do të marrin të njëjtat shërbime, por brenda bashkisë Berat

AKTUALITET / 13 September 2026, 16:41

Aktorja Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin Rama në Berat: Doja të flisja, ai u çua i irrituar

AKTUALITET / 13 September 2026, 16:13

Dënohet agjenti imobilar, u siguroi shqiptarëve 19 shtëpi në Angli për të mbjellë kanabis me vlerë 2 milionë sterlina

AKTUALITET / 13 September 2026, 15:23

Zbulohen detaje nga ngjarja e rëndë në Vorë, 56-vjeçari i la kushëririt plumbin në zarf në derën e shtëpisë

AKTUALITET / 13 September 2026, 14:12

Takimi në Berat, debate mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe aktore

AKTUALITET / 13 September 2026, 14:08

Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

AKTUALITET / 13 September 2026, 13:04

Taksat e naftës mbushin arkën e shtetit, 1.7 miliardë lekë më tepër që nga marsi

AKTUALITET / 13 September 2026, 12:46

Pagat e magistratëve, Rama:

AKTUALITET / 13 September 2026, 12:28

Dyshohet se kanosi

[Të gjithë të respektojnë
Kushtetutën, askush nuk
mund të kërcënojë askënd](#)

[kushëririn e tij për t'i marrë
300 mijë euro, arrestohet në
Vorë 56-vjeçari](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 11:17

[Stuhia godet Elbasanin, uji
pushton banesa, bodrume dhe
parkime nëntokësore \(VIDEO\)](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 11:09

['PISA 2025', pasqyra e
deformuar e suksesit të
qeverisë me arsimin](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 10:18

[Mbi 30 plumba ndaj makinës
së familjes që u kthye nga
Italia, autorët djegin mjetin në
Urakë](#)

AKTUALITET / 13 September 2026, 10:13

[Ngërçi me pagat e gjyqtarëve,
Rama: Gjykatësi fillestar në
Shqipëri merr 500 euro më
shumë se kolegët në Greqi](#)

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:59

[FOTO/ Pak ditë pas
sekuestrimit të 80 kg kokainë,
zbulohet tjetër sasi e madhe
pranë vilës së Lulzim Cakës
në Greqi, ja ku ishte fshehur](#)

AKTUALITET / 12 September 2026, 22:48

[Tritoli në banesën e mësuesit
në Shkodër/ Policia: Vetëm
dëme materiale, vijon puna
për kapjen e autorëve](#)

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES NJOFTIME NGA TPZ.AL 

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja
jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në
shërbim të interesit publik.



AKTUALITET SPORT
IDE TEJ E KETEJ
NË FOKUS BLOG
BALLKAN EMISIONE
BOTA
LIFESTYLE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.